



VENDIM

Nr. 95 Datë 28.07.2015

**PËR
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “GAMA ENERGY” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 , 37 germa d, dhe 110 te ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë ekelektike”, nenit 4 pika 1 germa “g”, neni 5 pika 2 dhe neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.07.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GAMA ENERGY” sh.p.k dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike për liçensim në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se :

1. Shoqëria Gama Energy sh.p.k ka aplikuar për tu pajisur me licensë për tregtimin energjisë elektrike në datën 27.04.2015 në zbatim të Ligjit nr. 9072, datë 23.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar. Bordi i ERE-s me vendimin nr. 66, datë 11.05.2015, miratoi fillimin e procedurave për tregtimin e energjisë të shoqërisë “GAMA ENERGY” sh.p.k.
2. Njoftimi i kërkesës për licencim të këtij subjekti është kryer ne zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 9072 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar
3. Në datën 15.05.2015 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
4. Në Ligjin nr 43/2015, neni 110 pika 1, është parashikuar që Ligji nr 9072 datë 22.05.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me ligjin nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, shfuqizohet.
5. Në Ligjin nr 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” në zbatim të detyrimeve që burojnë nga vete ligji në nenin 39 dhe nenin 108 pika 3 të tij, në nenin 110 pika 2 të tij parashikohet se : *Aktet nënligjore, që rregullojnë*

veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Për sa më sipër dhe duke qënë se aplikimi i shoqërisë “GAMA ENERGY” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gërmat “a”; “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “GAMA ENERGY” sh.p.k në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike për një afat 30 - vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE

Petrit Ahmeti

Në mungesë dhe me porosi

Adriatik BEGO